

MEMO

KALLËZUES: **Petro Gjiguria**, i biri i dhe, dtl., lindur dhe banues Himarë, me shtetësi greke dhe shqiptare, me adrese

BAZA LIGJORE: Neni 58/1 gërma “d” e vijues, nenet 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

DREJTUAR: Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Të Nderuar Prokurorë!

Shtetasi Petro Gjiguria ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasve Vangjel Tavo etj, në lidhje me veprimtarinë e paligjshme të tij gjatë procesin elektorak të zgjedhjeve të pjesshme të datës 04.08.2024 për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Siç është parashtruar në kallëzim, përveç fakteve të tjera të kallëzuara, shtetasi Vangjel Tavo në ushtrim të detyrës së tij si Prefekt i Qarkut Vlorë, dhe më tej subjekt zgjedhor, në bashkëpunim me punonjësit e gjendjes civile si dhe kryetarin në detyrë shtetasin Arqile Bollano kanë manipuluar listën e zgjedhësve të Bashkisë Himarë. Vetë I kallëzuar Vangjel Tavo, në një intervistë në një television kombëtar ka pohuar faktet e kallëzuara prej meje, duke deklaruar publikisht se kishte transferuar fiktivisht gjendjen civile të familjarëve të tij në Bashkinë Himarë.

Ditët e fundit në Kuvendin Kombëtar të Forumit Rinor të Partisë Socialiste njëri prej anëtarëve të saj, shtetasi Dasho Veizaj, duke e quajtur vehten “petalin më të bukur të Partisë Socialiste”, pohoi që ishte nga Lushnja¹ ishte lindur dhe rritur në atë qytet të vogël, ndërkohë po i njëjti

¹ https://youtu.be/J9m4Q4ZhTE4?si=zePË_r2ËEPifzFKY

shtetas në një rrjet social ka publikuar foton e tij duke votuar për zgjedhjet vendore të datës 04.08.2024 për Kryetar të Bashkisë Himarë².

Referuar deklarimeve publike të shtetasit Dasho Veizaj, provohet që është një nga anëtarët më të zellshëm të Partisë Socialiste, duke e quajtur vehten “petalin më të bukur” të kësaj Partie. Referuar këtyre deklarimeve të tij publike shtetasi Dasho Veizaj është lindur dhe rritur në Lushnjë. Referuar po publikimeve të tij, tashmë të bëra publike nga media, ky shtetas ka votuar në datën 4 gusht të vitit 2024 në Himarë. Duke patur parasysh parashikimet e ligjit për gjendjen civile nr. 10129/2009, neni 14 e vijues, transferimi i gjendjes civile kërkon disa kushte, të cilat kanë të bëjnë me banimin apo qëndrimin për një periudhë të caktuar në një njësi administrative, si dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës, dokument pronësie apo kontratë qiraje, në zyrën e gjendjes civile të njësisë administrative ku kërkohet të deklarohet vendbanimi I ri.

Sa kohë që shtetasi Dasho Veizaj, publikisht deklaron se ka lindur dhe është rritur në Lushnjë, ka dyshime të arsyeshme se transferimi prej tij I gjendjes civile në bashkinë Himarë është kryer në shkelje të ligjit nr. 10129/2009 duke përdorur dokumentacion të falsifikuar për të provuar vendbanimin apo qëndrimin e tij në Bashkinë Himarë, me qëllim mbështetjen e një subjekti të caktuar zgjedhor, konkretisht kandidatit të Partisë Socialiste, “petal” I së cilës është edhe ai.

Kërkoj që krahas ndjekjes penale të shtetasve të kallëzuar më parë, të ndiqet penalisht shtetasi Dasho Veizaj, pasi kundrejt përfitimeve që I ka premtuar Partia Socialiste, ka ndryshuar vendbanimin, duke përdorur dokumenta të falsifikuara pasi realisht ky shtetas nuk është banor I Bashkisë Himarë, duke konsumuar veprat penale të parashikuara në nenet 190 të K.Penal, duke dhënë rrethana të rreme në formularët dhe kërkesat drejtuar zyrës së gjendjes civile, si dhe atë të parashikuar në nenin 328/b të K.Penal, pasi këto veprime të tij janë kryer kundrejt premtimeve për favorizime të ndryshme nga Partia Socialiste. Për të provuar këto fakte është e nevojshme sekuestrimi I praktikës së ndryshimit të gjendjes civile të shtetasit Dasho Veizaj, tabulatet telefonike të tij, për të konstatuar duke u bazuar mbi antenat e shërbimit të telefonisë celulare vendqëndrimin e tij më të zakonshëm, nëse ka qënë në afatet e parashikuara në ligjin nr. 10129/2009 me vendqëndrim të zakonshëm në Bashkinë Himarë.

Ky verifikim duhet të kryhet edhe për shtetasit e tjerë të kallëzuar, përfshirë edhe vetë kandidatin Vangjel Tavo, apo shtetasin Dritan Shakohoxha, I cili megjithëse person publik në Tiranë, rezultoi që të në vitin 2024 të ketë ndërruar vendbanim familjarisht duke u bërë banor I bashkisë Himarë për zgjedhjet e datës 4 gusht 2024. Duke krahasuar qelizat telefonike të shërbimit të telefonisë celulare të këtyre shtetasve, do të rezultojë qartësisht nëse kanë banuar në territorin e bashkisë Himarë, apo janë “banorë” vetëm për zgjedhjet e kësaj bashkie, duke përdorur në këtë mënyrë dokumente të falsifikuara në praktikën e ndryshimit të vendbanimit të tyre.

² <https://ëëë.syri.net/politike/763829/ekskluzive-petalja-me-e-bukur-e-trendafil-it-socialist-tha-jam-nga-lushnja-por-votoi-ne-himare-per-vangjel-tavon/>

Gjithashtu në kallëzim kemi referuar raste të përdorimit të administratës publike për qëllime elektorale. Përveç rasteve të përdorimit të Kadastrës dhe shërbimeve që ofron ky institucion shtetëror, nga faqja zyrtare e KQZ kemi konstatuar se në dispozicion të kandidatit Vangjel Tavo është vënë edhe pasuria publike, e tillë si Shkolla e Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh. Referuar Vendimit datë 05.12.2024 të KAS “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 4 datë 15.11.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve” konstatohet se nga Bashkia Himarë, e cila administron pasurinë publike, godinat dhe territoret e shkollave publike, I është vendosur në dispozicion kandidatit të Partisë Socialiste territori I kësaj shkolle për të kryer aktivitet elektorale.

Kjo veprimtari është pranuar nga I kallëzuarit Vangjel Tavo, por KAS nuk ka patur vendimmarrje për shkak të mungesës së anëtarit Ilirjan Rusmali. Ky I fundit, në shpërdorim të hapur të detyrës, në të njëjtën ditë, në datën 05.12.2024, në orën 11 ka qënë I pranishëm në mbledhjen e KAS, kur duhet të zvogëlohej masa e gjobës së propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndaj Partisë Socialiste, fakt I provuar nga vendimi nr. 3 datë 05.12.2024 I KAS. Në orën 11/30 të të njëjtës datë, kur objekt shqyrtimi ishte propozimi I Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për gjobitjen e të kallëzuarit Vangjel Tavo dhe punonjësit të administratës publike përkatës, për përdorim të pasurisë publike, shtetasi Ilirjan Rusmali nuk merr pjesë në vendim duke e bërë të pamundur marrjen e vendimit në lidhje me këtë konstatim.

Sipas nenit 328/a të K.Penal ndalohet përdorimi I të mirave publike për të favorizuar një kandidat të caktuar. Në rastin konkret, ashtu si dhe është parashtruar në kallëzim, në lidhje me përdorimin e punonjësve të administratës publike, I shërbimeve të Kadastrës për qëllime elektorale, pranuar në deklaratimet publike të të kallëzuarit Vangjel Tavo, nga Bashkia Himarë, që administron territorin e institucioneve arsimore, është lejuar përdorimi I kësaj të mire publike, me qëllim favorizimin e kandidatit Vangjel Tavo.

Po ashtu referuar të dhënave të Drejtorisë së Thesarit, për konsumin e karburantit, apo kohë-qëndrimin, shërbimet, etj, është e nevojshme të hetohen shpenzimet e administratës publike në muajin korrik deri në datën 04.08.2024, pasi nga konstatimet publike, I gjithë aparati I Këshillit të Ministrave, disa kryetarë bashkie të bashkive socialiste, kryetari I bashkisë Vlorë, Fier, Tiranë, kanë qënë në territorin e bashkisë Himarë dhe kanë marrë pjesë aktivisht në fushatë elektorale në favor të kandidatit të Partisë Socialiste, të kallëzuarit Vangjel Tavo. Po ashtu janë konstatuar të gjithë ministrat kryesisht kryeministri Edi Rama, zv/kryeministrja Belinda Balluku, Taulant Balla, Elisa Spiropali, etj kanë marrë pjesë aktivisht në fushatë elektorale. Në rast se këta shtetas kanë përdorur karburantin apo kanë përfutuar dieta shërbimi etj, kanë konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 328/a I K.Penal, duke qënë se janë përdorur të mira publike, mjete financiare shtetërore, me qëllim kryerjen e fushatës elektorale në mbështetje të kandidatit të Partisë Socialiste.

Me cilësinë e kallëzuesit, kërkoj informacion në lidhje me gjendjen e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e paraqitur prej meje në muajin korrik 2024, pasi në zgjedhjet e datës 4 gusht në bashkinë Himarë, nuk u lejuan të votojnë banorët autoktonë të kësaj bashkie, ndërkohë që janë lejuar të transferojnë gjendjen civile me dokumenta të falsifikuara dhe në kundërshtim flagrant me ligjin nga punonjësit e gjendjes civile, të punësuar të prefektit, i cili më vonë u bë kandidat, familjarët e kandidatit Vangjel Tavo, apo “petale” të Partisë Socialiste që nuk kanë lidhje me bashkinë Himarë.

Po ashtu kërkoj kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve në lidhje me faktet e kallëzuara si më lart. Përdorimi i të mirave publike nga punonjës shtetërorë me qëllim favorizimin e kandidatit Vangjel Tavo, ishte një fenomen i hapur, flagrant dhe arrogant i qeverisë, dhe është e nevojshme të hetohet dhe të vendosen para përgjegjësive autorët.

Duke Ju falenderuar paraprakisht

KALLËZUES

PETRO GJIKURIA